



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/95

Datë: 11.02.2019

Procesverbal

i mbledhjes se I (e parë) për vitin 2019 e Komitetit për Politikë dhe Financa

REND I DITES

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës për vitin 2019 i Komitetit për Komunitete.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës për vitin 2019 i Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës për vitin 2019 i Komitetit për Shëndetësi dhe Mireqenie Sociale, dhe Persona me Aftësi të Kufizuara.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës për vitin 2019 i Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalid, Veteranë të Luftës së UÇK-së, si dhe të Martirëve të Luftës.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës për vitin 2019 i Komitetit për Diasporë.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës për vitin 2019 i Komitetit për Planifikim Urban, Kadastër, Turizëm, Mbrojtje të Mjedisit dhe monitorim të projekteve publike.
8. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës për vitin 2019 i Komitetit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.
9. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës për vitin 2019 i Komitetit për Barazi Gjinore.
10. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës për vitin 2019 i Komisioni Komunal të Aksionarëve.
11. Miratimi i Rregullores për tokën bujqësore në Komunën e Malishevës.
12. Shqyrtimi i Raportit të Kompanisë "Ekoregjioni" njësia në Malishevë për vitin 2018.
13. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve të varrimit për vitin 2018, dhe procedurat e mëtutjeshme për vitin 2019.
14. Inicimi i procedurave për dhënie në shfrytëzim të pishinës publike në fshatin Banjë.
15. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Zyrës së Prokurimit Publik për vitin 2019.
16. Inicimi i Procedurave për hartimin e Rregullores për Ndarjen e Dekorativave për Javën e Diasporës.
17. Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme.
18. Të Ndryshme

Mbledhja filloj në ora 10, morën pjesë 5 anëtarë të KPF, përfaqësuesi i Osbe, zyra për informim.

Rrahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve jemi në mbledhjen e parë rendin e ditës e keni me material, janë edhe disa kërkesa. Një kërkesë që e kemi pas për ndërrim destinim për Arsim Krasniqin nga Carralluka, kjo ishte në kontest gjyqësor ashtu kanë thënë Drejtoria e Gjeodezisë.

Muharrem Morina: Ky ka kërkuar nga kryetari i Komunës leje ndërtimi por kryetari ja ka refuzuar, sepse atë vend ai e ka bllokuar në hyrje ama me letra në emër të vet e ka.

Alban Krasniqi: Duhet me na interesuar pse me ba ndërrim destinim kur kryetari ja paska refuzuar, ape dini se asnjë pëllëmbë toke nuk na mbeti.

Rrahim Morina: Gjykata ka kërkuar me kthi po presim e në një mbledhje tjetër e debatojmë.

E kemi pas një kërkesë të Kryqit të Kuq për hapësira për zyre, pas konsultimit me Kryetarin e Komunës dhe shoqatën që ka kërkuar ata kanë thënë se të Dardania ju konvenon më shumë si hapësire për zyre.

Muharrem Morina: Një vend është edhe ku ka qenë shoqata e grave.

Alban Krasniqi: Te definohet sakte të precizohet vendi pastaj mundemi me debatuar.

Rrahim Morina: Rreth rendit të ditës prokurimit ju kemi kërkuar Planin e punës por se kanë sjellë.

Alban Krasniqi: Është një kërkesë për ndërrim të një anëtar nga subjekti Vetëvendosje ne edhe me shkrim e sjellim propozimin e ri për anëtar në Komitetin për Shëndetësi.

Rrahim Morina: Kush jeni për këtë rend të ditës? Unanimisht ishin për 5 anëtarët e KPF-së.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Rrahim Morina: A keni diçka rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Unanimisht ishin për 5 anëtarët e KPF-së.

Rrahim Morina: I kemi tash disa pika krejt janë plane të Komiteteve kisha kërkuar që t'i rekomandojmë të gjitha fjala është për pika çka janë plane punë për këtë vit. Atëherë nëse jeni të pajtimit kush jeni që nga pika 2 deri në pikën 10 t'i rekomandojmë për Kuvend? Unanimisht ishin për 5 anëtarët e KPF-së.

11. Miratimi i Rregullores për tokën bujqësore në Komunën e Malishevës.

Milaim Morina: Ju përshëndes kam ardh te jap sqarimet prej drejtorisë për Bujqësi, pas një punë të gjatë me grupet politike kemi ardhur në përfundim dhe kemi bërë disa përmirësime tash draft rregullorja për tokën bujqësore është gati, kërkoj nga ana e juaj ta rekomandoni për Kuvend.

Alban Krasniqi: Kjo rregullore është vonuar pasi ka kohë që i ka kaluar gjitha procedurat, me kërkesën e drejtorisë së Bujqësisë jemi takuar edhe një herë me zyrтарin nga kjo drejtori, zyrën e kryetarit, Komitetin për Bujqësi, shefat e grupeve janë dhënë disa sugjerime për ndryshime. Tani në titull ceket edhe për mbrojtjen e tokës bujqësore, pastaj a fut databaza për tokën bujqësore, një nene cek që procedurat duhet të ndiqen nga drejtoritë pastaj kërkesat të vijnë në kuvend, se deri tani kanë kaluar ndërrim destinime që ndoshta ka pas edhe shkelje sepse as dokumentet su lexoheshin e tash të gjitha i barten nivelit të Administratës që hyn kostoja, mbrojtja e tokës, qiraja krejt të futen sipas Ligjit.

Hashim Vrenezi: Te pjesa e qerasë ku ceket e kam te pa qartë, a është fjala për çdo lloj toke pasi që për pronën personale mendoj që ska nevojë të ceket qiraja, pastaj sa është kohëzgjatja e dhënies ose të kullosat si do të jetë.

Alban Krasniqi: Tokën publike me qira e jep Komuna, ama këtu është fjala për token bujqësore.

Rrahim Morina: Mund të ceket Ligji për dhënie në shfrytëzim.

Alban Krasniqi: Ne jemi në fazën përfundimtare për miratim të kësaj draft Rregullore, ne gjitha propozimet i kemi dhënë prej bazës ligjore.

Hashim Vrenezi: Ne s'mund të fusim diçka që është jashtë kompetencës tone e ne me fut ne rregullore.

Rrahim Morina: Kush është ta rekomandojmë për Kuvend duke shikuar në kuvend nenin 22 dhe 23? Unanimisht ishin për 5 anëtarët e KPF-së.

12. Shqyrtimi i Raportit të Kompanisë "Ekoregjioni" njësia në Malishevë për vitin 2018.

Alban Krasniqi: Kompania nëse ka mundësi të na pasi me një listë të punëtorëve sa janë, qysh janë kontratat, qysh janë përzgjedhë, statusi i tyre, mënyra e pranimit a ka pas konkurs a jo kur janë marrë ata punëtor.

Rrahim Morina: Si kryesues gjitha drejtorive ju kam dërguar kërkesat me shkrim sipas planit që ka miratuar kuvendi, po ashtu edhe prej kryetarit kam kërkuar të na pasi material.

Alban Krasniqi: Sipas ligjit, Udhëzimeve Administrative kjo kompani obligohet ta ketë edhe planin e biznesit.

Rrahim Morina: Kush është ta rekomandojmë këtë pikë për Kuvend? Unanimisht ishin për 5 anëtarët e KPF-së.

13. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve të varrimit për vitin 2018, dhe procedurat e mëtutjeshme për vitin 2019.

Hashim Vrenezi: Te kjo pikë s'kam diçka vërejtje edhe pse të shpenzimet diku i kam pa 140 e diku 200, si raport mendoj është në rregull.

Alban Krasniqi: Në kemi të drejt për çdo raport me kërkuar sqarime, unë e kam breng se ka dikush që ndoshta shpenzimet e varrimit i hjek vet e këta në raport i fusin si shpenzime, e ndoshta ka shërbim që sa krye. Është mirë mi pa formularët qysh janë plotësuar. Ne vet e kemi pas rastin në familje kur na ka vdek prindi, e kemi ble vet arkivolin e pse ne tash me ju formalizuar ato shpenzime ne vlerë 200 euro absolut jo.

Muharrem Morina: Ka rast që familja vet e blen arkivolin për familjarin e vet kur t'i vdes ama na si Komunë sja kemi pranë kur ka ardh çështja të shpenzimi.

Raimonda Krasniqi: Ka rast që shkon dikush nga familja edhe e nënshkruan atë formular.

Rrahim Morina: Ne mund t'i kërkojmë formularët për secilin rast, mund t'i kërkojmë edhe nga BIK, nga Drejtoria për Shërbime Publike raport financiar.

Alban Krasniqi: Unë po du me ditë a po zbatohet, sepse sipas këtij raporti për 6 muaj nuk po del askush që se ka pranë këtë shërbim e që ndoshta me këqyr ka raste që vet i kanë hjek shpenzimet ditën e varrimit.

Rrahim Morina: Kush është ta rekomandojmë këtë pikë për Kuvend? Unanimisht ishin për 5 anëtarët e KPF-së.

14. Inicimi i procedurave për dhënie në shfrytëzim të pishinës publike në fshatin Banjë.

Rrahim Morina: Ne kemi dërgu një kërkesë në MAPL për sqarime, sepse aj që ka pas pishinën deri tani ka kërkuar me ja fal një pjesë të borxhit, e tash për vitin 2019 kërkesën e kemi sjellë me kohë.

Hashim Vrenezi: E kemi rastin se pala ka kerku meja falë borxhin. Ide e imja është që pishinën me dhanë për 2 ose 3 vite sepse mundet me kanë një vit me mot te keq por jo edhe viti tjetër, e çmimi mund te jetë i njëjtë për secilin vit e nëse aj që e merr se paguan për një vit mund të ja ndërpresim kontratën.

Alban Krasniqi: Çka kam paralajmëruar ashtu edhe ka ndodhë, qysh kanë dështuar kriteret kur janë votuar e që tash s'janë zbatuar, sepse nuk shihet që ka rezultuar në shërbime dhe në çmime ose një sjellje e mire, sepse aty për me hy një far forme përdoret sikur qasje policore ose me naj far kazino. Pastaj e ka rrite konkurrencën mes grupeve aty në fshat e që ne fakt sja ka vlejti çka a ba aty deri tash, një fitim minimal në një aset human e që mund me ndodhë edhe në të ardhmen, për me zhvillu turizmin duhet krejt mu trajtuar njëjtë. Mënyra me e mirë është që kjo të merret ne shfrytëzim nga Komuna me një plan biznesi, një renovim me çmime për të rritu 1 euro, për një pjesë 50 cent e fëmijët e vegjël pa pare. Me ba një plan afatgjatë për këtë pishinë, ta menaxhoj Drejtoria e Shërbimeve Publike t'i kthehet pra publiku të behet funksionimi si duhet i saj e jo veç fitimi, sepse një plan afatgjatë ka pas pengesa sepse deri tash ska paraqit asnjë projekt ashtu qysh kanë thënë. Aty çdo send bëhet si në perëndimin e egër.

Valon Krasniqi: Aty një objekt që është i ndërtuar afër pishinës i kujt është.

Rrahim Morina: Objekti aty afër është privat një pjesë e atij objekti është uzurpim i pronës publike por kjo është çështje e organeve. Rreth pishinës ne çdo vit e japim e asgjë nuk investohet aty, e që krejt mjetet është mirë aty te investohen, duhet plan afatgjatë, se aq fitim aty ka pas sa që i kanë ble aty afër edhe disa prona private. Edhe unë jam të jepet në shfrytëzim për dy vite por të investohet aty.

Valon Krasniqi: Pa u fut qytetaret e Banjës që edhe ata me pagu kur hyjnë aty sukses ska me pas.

Alban Krasniqi: Komunës po ja bekojmë 15 milion buxhet e tash pishinën spo ja besojmë, e më shumë ka të hyra kjo pishinë se sa Stacioni Autobusëve, sepse nëse i jepet Komunës ato çadrat brenda mund te jepen për një çmim me kontratë për 4 muaj me parapagim edhe me mbikëqyr Kuvendi.

Hashim Vrenezi: Edhe Komuna ne rastet kur i jep dikujt në shfrytëzim duhet me përcjelle punën e tij.

Rrahim Morina: Kush është ta rekomandojmë këtë pikë për Kuvend? Për ish-in 4, kundër 1, abstenime s'kishte.

15. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Zyrës së Prokurimit Publik për vitin 2019.

Alban Krasniqi: Këtë pikë pa plan nuk është dashtë me fut në rend dite hiq.

Rrahim Morina: Unë këtë plan e kam kërkuar në zyrën e prokurimit, por nuk e kanë sjellë, por që nuk e sjellin deri në mbledhjen e Kuvendit asnjë pikë të kryeartit të Komunës nuk kemi me shqyrtuar.

Rrahim Morina: Kush jeni ta rekomandojmë këtë pikë për Kuvend? Unanimisht ish-in për 5 anëtarë.

16. Inicimi i Procedurave për hartimin e Rregullores për Ndarjen e Dekorativave për Javën e Diasporës.

Rrahim Morina: Kush është ta rekomandojmë këtë pikë për Kuvend? Unanimisht ish-in për 5 anëtarë.

17. Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme.

Kërkesa nr.02/262 të datës:26.12.2018 e parashtruar nga Demush Osman Krasniqi nga fshati Drenoc për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme.

Rrahim Morina: Këtë kërkoj duhet ta përcjellim të kryetari i Komunës aj duhet me dhanë një arsyetim.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo kërkesë t'i përcillet zyrës se kryetarit të Komunës? Unanimisht ish-in për 5 anëtar.

Kërkesa nr.02/14 të datës: 10.01.2019 e parashtruar nga zj.Rabishe Mazreku nga Malisheva, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Alban Krasniqi: Kjo kërkesë nuk ka asnjë shkresë nga drejtoritë e që ishte dashtë me na sjellë me shkrim, dhe kjo kërkesë nëse përcillet është në kundërshtim.

Muharrem Morina: Ne drejtorisë mundemi mi kërkuar në Kuvend me sjellë përgjigjen, sepse prapë në fund Ministria vendosë.

Rrahim Morina: Nëse jeni të mendimit e përcjellim për drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Shërbim Pronëso-ro-Juridik për sqarime se prona që kërkohet t'i bëhet ndërrim destinimi a është në projektin e trasesë së transitit në Malishevë.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo kërkesë t'i përcillet Drejtorisë për Gjeodezi dhe kadastër? Për ish-in 4, kundër s'kishte, abstenime 1.

Njoftimi nr.02/556 i datës:20.12.2018 të parashtruar nga zyrtarja për Barazi Gjimore në Komunën e Malishevës znj.Vera Bytyçi, për paraqitjen e dorëheqjes nga anëtarja e Komitetit për Barazi Gjimore ne Kuvendin e Komunës.

Alban Krasniqi: Kur Kuvendi i jep dikujt përgjegjësi s'mundet tash ne ket rast me dhanë dorëheqje.

Rrahim Morina: Ne është mirë deri në mbledhjen e ardhshme me kërkuar nga zyrtarja për barazi gjinore një arsyeshmeri se pse kërkon të tërhiqet nga Komiteti për barazi gjinore.

Rrahim Morina: Kush jeni që zyrtaret t'i kërkohej një arsyetim për ofrimin e dorëheqjes? Unanimisht ishin për.

Rrahim Morina: I kemi dy kërkesa për zëvendësim të anëtareve në Komitetin për shëndetësi, njëri anëtar nga LDK dhe njëri nga VV, kush jeni t'i rekomandojmë për Kuvend? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/23 datë: 14.01.2019 e parashtruar nga Ibrahim Morina nga fshati Astrazup.

Rrahim Morina: Ky ka kërkuar një rrugë sepse spo ka rrugë për me lëvize prej shtëpive që ka ndërtuar. Ne kemi pas këso raste dhe ne këtë rast në vetëm ja lejojmë kalimin dhe e bëjmë prone shoqërore rrugëve.

Alban Krasniqi: Kuvendi vendos vetëm kur është interesi i Komunës e jo si në këtë rast, ne tash s'mundem kush do të kërkon t'i bëhen shtigje për kalim. Urbanizmi është dashtë të dalin në teren me pa gjendjen si është e jo me na ardh kërkesa neve në Komitet.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo kërkesë të rekomandohet për kuvend? Për ishin 4, kundër 1, abstenime s'kishte.

Alban Morina: Kryesues mos me detyro me kërkuar edhe prej Gjykatës në formën qysh po i hedh për votim kërkesat, e qysh kërkohej në këtë rast të kjo kërkesë. Nuk jemi ne me vendosë vija për qytetaret, sepse me këtë kërkesë duhet të merret urbanizmi e jo ne dhe pa material nga drejtorja s'është dashtë me hedh në votim.

Kërkesa nr.02/09 datë: 08.01.2019 e parashtruar nga Shoqata e Arsimitarëve Pensionist në Komunën e Malishevës.

Rrahim Morina: Edhe kjo shoqatë ka kërkuar hapësira për zyre, kush jeni ta rekomandojmë për Kuvend aty e debatojmë? Për ishin 4, kundër 1, abstenime s'kishte.

Rrahim Morina: Ju falënderoj për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:10 min.

Procesmbajtësi

Naim Avdijaj jur. i dip

